

**STATUT  
PER  
SHOQERINE  
"AFerhati" SH.P.K.  
(Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar)**

Në bazë të ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe ligjit nr.9723. date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" une i nënshkruari shpall si më poshtë vijon:

**Neni 1**

**FORMIMI I SHOQËRISË**

Formohet shoqëria e quajtur **"AFerhati" SH.P.K.** (Qe ketu e me poshte referuar si "Shoqeria"), e cila themelohet nga 1 (një) Ortak i vetem me 100% te kontributeve si me poshte :

**Z. Ahmet Ferhati**, i biri i Ferhat Ferhati, lindur me 20.08.1968, shtetas shqiptar, lindur ne Tiranë dhe banues ne Tiranë, mbajtes i ID me numer personal G80820185T, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, ortak me 100% te kontributeve baras me 100,000 leke.

**Neni 2**

**QENDRA E SHOQËRISË**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresen: Rruga "Dritan Hoxha", Kompleksi Karavan, përballë hyrjes së Laprakës, Kati 1 1/8, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithë vendin gjate aktivitetit te saj, brenda ose jashte territorit te vendit.

**Neni 3**

**KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE**

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë e pacaktuar. Shoqëria mund te perfundoje, te vihet ne likujdim perpara ketij afati ose mund te zgjase aktivitetin e saj me vendim te Asamblese se Ortakeve.



## Neni 4

### OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

- Tregtim me pakice dhe shumice të pjesëve të këmbimit për makineri të të gjitha llojeve, karburanteve dhe vajrave lubrifikante. Importe dhe eksporte të të gjitha materialeve të lidhura direkt ose indirekt me objektin kryesor. Dhenia e shërbimit për servise makinash. Blerje, shitje makinash të ndryshme përfshi ato të blindura. Dhenija me qera e automjeteve individuale, shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore.

- Ajo do të ushtroj veprimtari edhe në fushat e mëposhtme:

1. Importimin dhe eksportimin, prodhimin, përpunimin, transformimin dhe tregtimin e mallrave dhe paisjeve të ndryshme të konsumit, paisjeve elektronike, materialeve të ndërtimit dhe mallrave ushqimore.
2. Ajo ka të drejtë të ushtroj aktivitetet në fushën e shitjes së pasurive të paluajtshme duke u pajisur me licencat e nevojshme për këto qëllime nga organet kompetente.
3. Shoqëria mund të blejë, të hyjë në marrëdhënie *leasing* dhe të marrë apo të japë me qira terrere, impiante dhe uzina, mund kryejë, përveç aktivitetëve tregtarë edhe aktivitete si industriale ashtu edhe bujqësore.
4. Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, financiare dhe kreditore si edhe të blejë apo shesë apo të marrë apo japë me qera pasuri, si edhe të ketë interesa apo pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume, të themeluara apo në themelime të siper, që kanë një objekt të ngjashëm apo funksional në arritjen e qëllimeve të Shoqërisë, si dhe të ofrojnë garanci, të marrë hua dhe të ofrojnë garanci, pasurore apo personale, në favor të të tjerëve. Në përgjithësi, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj.
5. Shoqëria mund të kryejë tregtinë e materialeve farmaceutike e tjera.
6. Të kryejë shërbime transporti dhe shërbime VIP (Ruajtjes fizike me truporje dhe shërbime me mjete të blinduara, transferime të vlerave monetare me automjete të blinduara).
7. Pritje, akomodim me të gjithë llogjistiken e nevojshme për delegacione të huaja për të gjitha aktivitetet që ata do të kryejnë në Republikën e Shqipërisë.



8. Blerja, shitja e medikamente dhe materialeve ndihmese per shendetesine, kancelari e te tjera materiale per fusha te ndryshme.
9. Sherbimi i pastrimit te ambiente publike dhe private.
10. Shitje peme dekorative, luleve dhe peme prodhuese frytore e te tjera.
11. Prodhim dhe tregti produktesh bujqesore dhe blegtorale.

#### Neni 5

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë kapitalin sipas vendimeve të Ortakeve sipas legjislacionit ne fuqi.

#### Neni 6

### KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestar i shoqerise është 100.000 (njqind mije) lekë dhe i ndarë në kuota me te njëjtën vlerë por asnjëherë më e vogël se 1.000 (njemije) lekë. Kapitali perbehet nga 1(një) kuotë dhe zotërohet 100% nga:

- **Ortaku i vetem i shoqerise Z. Ahmet Ferhati**, mbajtes i ID me numer personal G80820185T, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar me **1 (një) kuotë baraz me 100%**.

Ortaku mund te vendosi te rrisi kapitalin e shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te asamblese se ortakeve sa here qe shoqeria te kete nevoje per tu mbuluar financiarisht per zhvillimin normal te aktivitetit te saj kur ajo te kete te papaguar furnitore etj mungesa te likujditetit ose dhe me kontribut ne natyre.

Detyrimet e ortakut kundrejt shoqerise do te mbuloen vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tij. Ortaku nuk do te kete asnje pergjegjesi tjeter per detyrime te tjera te shoqerise.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrime te marra nga administratori per qellime qe nuk perputhen me ato te paracaktuara nga ky Statut, si edhe per detyrime te marra nga Ortaku ne emrin e tij personal.



## Neni 7

### REGJISTRIMI I SHOQERISE

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar në datën e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit (QKB), sipas nenit 43 të ligjit 9723 date 03.05.2007.

## Neni 8

### KALIMI I KUOTAVE DHE E DREJTA E PARABLERJES

Kuotat e kapitalit të shoqërisë si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nepermjet:

- a) kontributit në cash dhe në natyrë në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes së kuotave
- c) trashëgimise
- d) dhurimit
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës nga casti i kalimit të kuotave deri në castin e regjistrimit të kalimit.

- Pjesët e kapitalit mund t'u transferohen të tretëve teresisht ose pjesërisht, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve
- Transferimi për çfarëdo arsyeje, teresisht ose pjesërisht i pjesëve të kapitalit të Shoqërisë është subjekt i së drejtës së parablerjes në favor të ortakëve të tjerë, të cilët mund të ushtrojnë këto të drejta në raport me pjesët e tyre të kapitalit, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit të dërguar me leter rekomandim. Në këtë njoftim duhet të saktësohet emimi i kërkuar, i cili duhet të jetë i arsyeshëm dhe i njëjtit me atë që do të ofrohet një personi të tretë, jashtë shoqërisë. Në rast se ortakët e tjerë nuk përgjigjen brenda afatit të parashikuar, konsiderohet se ata kanë hequr dorë nga ushtrimi i të drejtës së parablerjes.
- Të gjitha njoftimet e sipërpermendura do të behen me shkrim dhe i adresohen Administratorit të Shoqërisë.



## Neni 9

Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emri i administratorit, duhet te permenden ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

## Neni 10

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore.

Organet e shoqerise jane:


- 1- Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë
- 2- 1 (një) Administrator

## Neni 11

### KOMPETENCAT E ORTAKUT TE SHOQERISE

Per menyren e drejtimit dhe ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, Asambleja e Ortakeve shprehet me vendime per gjithcka qe eshte ne kompetencat e saj te pershkruara si me poshte:

- Ka te drejte te beje ndryshime ne statut.
- Percakton politikat tregtare te shoqerise.
- Ka të drejtë të miratojë bilancin e shoqerise dhe te bej ndarjen e fitimit.
- Ai emerone ose shkarkon administratoret, likujduesit, ekspertet kontabel te autorizuar.
- Mbikeqyr zbatimin e politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Miratimin e pasqyrave vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Miraton rritjen ose zvogelimin e kapitalit.
- Percakton shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.
- Miraton pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.



- I jep autorizimin Administratorit ta perfaqesoj shoqerine ne gjykate, kryen riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miraton rregullat procedurale te mbledhjeve te asamblese se ortakeve.
- Miraton lidhjen e kontratave per dhenie dhe marrje te drejtash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqerise si dhe kontrata ne lidhje me organet shtetore per pjesmarrjen ne tender, ankande ose aktivitete te tjera te rendesishme.
- Realizon blerje, shitje si dhe tjetersim te pasurive te palujtshme te shoqerise ne perputhje me kriteret qe i jep ligji per shoqerite tregtare etj.
- Merr vendime te tjera ne dobi te veprimtarise tregtare.


### Neni 12

Marrja e vendimeve te Ortakeve regjistrohet ne regjistrin e vendimeve te ortakeve, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

### Neni 13

#### THIRRJA E ASAMBLESE

Asambleja e Ortakeve nese shoqeria do te kete me shume se 1 (nje) ortak thirret sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblese se ortakeve thirret te pakten nje here ne vit. Asambleja e ortakeve thirret nga Administratori ose nga ortaku i cili perfaqeson te pakten 5% te totalit te votave ne Asamblene te Ortakeve te Shoqerise. Asambleja e Ortakeve thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nepermjet postes elektronike 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese se ortakeve. Njoftimi ne te dyja format e mesiperme duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites.



## ADMINISTRIMI

Shoqeria administrohet nga nje administrator i cili caktohet ne statutin e shoqerise nga Asambleja e Ortakeve. Administratori qendron ne detyre per nje periudhe jo me te gjate se 5 vjet me te drejte ripertesitje kohore dhe ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e tij, asambleja e ortakeve vendos shkarkimin e tij per shkaqe te arsyeshme.

Administratori detyrohet te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme.

Ai kujdeset per mbajtjen sakte dhe te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise.

Ai pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor te shoqerise, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumente para asamblese se pergjithshme per miratim.

Ai ka te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise jua jep shprehimisht Asamblese se ortakeve.

Administratori ka te drejte te nenshkruajne per kontrata te ndryshme, per furnizime publike private, cdo lloj operacioni bankar, te veproje me cdo lloj instituti bankar publik e privat, te ndermarre veprime gjyqesore, transaksione te ndryshme, etj.

Te gjitha veprimet e tjera duke perfshire pagesa dhe detyrime per tu paguar ose veprime me insitucionet bankare ku perfshihen transferta bankare dhe terheqje parash qe do te ndermerren nga Administratori per llogari te shoqerise, eshte e nevojshme dhe e detyrueshme nenshkrimi i Administratorit se bashku me vulen e shoqerise, ne menyre qe keto veprime te jene te detyrueshme per shoqerine.

**Administratori nuk mund te kryeje pa miratimin e Asamblese se Pergjithshme:**

- Lenien peng ose ne hipoteke te pasurive te shoqerise;
- Shit-blerje te pasurive te paluajtshme ne pronesi te Shoqerise;
- Te kontraktoje ne cfaredo lloj forme qofte, te marri hua tek shoqeria, te japi pelqimin ne emer te saj per paradhenie si dhe te behet dorezanes apo te garantoje ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve

Administratori i shoqërisë është **Z. Ahmet Ferhati**, shtetas shqiptar, me numer personal G80820185T, madhor e me zotësi të plote juridike për të vepruar. Ai do ta ushtrojë këtë detyrë për një periudhë 5 vjeçare. Me të drejtë rinovimi.

#### Neni 15

### MARREDHENIET E PUNES

Marredheniet e punës rregullohen nepermjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për demot që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

#### Neni 16

### KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretet e të gjitha aktet dhe dokumentet që janë përcaktuar si të tilla.

#### Neni 17


### EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL

Kontrolli mbi veprimtarinë e shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do të qendrojë në detyrë për atë sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet nga Asambleja e Ortakëve. Ortaket përcaktojnë edhe shpërblimin përkatës midis tyre si marredhenie dy palësh.

#### Neni 18

### VITI FINANCIAR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të secilit vit. Administratori merr masat lidhur me përlogaritjen e rezultateve ekonomike të fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit të ceshtjeve të mesipërme si dhe shlyerjen e detyrimeve, mbasi eksperti kontabel t'i ketë





certifikuar ato si te verteta dhe te sinqerta atehere asambleja e ortakeve vendos se cfare do te bej me fitimin apo humbjen e shoqerise ne se do te ndahen si dividend apo do te shtoj kapitalin e saj.

#### Neni 19

### SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Ne rast se shoqeria shperndahet per cdo lloj arsye Ortaket percaktojne menyren e likuidimit, emerojne nje ose me teper likuidator dhe pergatisin te gjitha dokumentet e nevojshme per çregjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

#### Neni 20

### ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij Statuti do te zgjidhen me mirekuptim dhe do te diskutohen ne menyre te drejtperdrejte midis paleve te interesuara.  
Ne rast se nuk do te arrihet nje zgjidhje me mirekuptim te mosmarreveshjes, ajo do ti besohet Gjykates se Rrethit Tirane.

#### Neni 21

### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit ".Cdo ndryshim behet ne perputhje me kete Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie. Per cdo gje qe nuk eshte shprehur ne statut merret ne konsideratë ligji dhe aktet nen ligjore ne fuqi Statuti eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

Tirane, me 07/03/2023

### ORTAKU I SHOQERISE

Z. AHMET FERHATI

